

Trajnim në temë “Mekanizmat dhe instrumentet për krijimin e politikave publike dhe përfaqësimi i të drejtave të pakicave”

Nga 22 deri 24 prill të vitit 2008 në Shkup u mbajt trajnim në temë “Mekanizmat dhe instrumentet për krijimin e politikave publike dhe përfaqësimi i të drejtave të pakicave”.

Trajnimin e ndoqën 33 pjesëmarrës nga Shkupi dhe Tetova (9 përfaqësues të njësisve të vetëqeverisjes lokale dhe institucioneve, 22 përfaqësues të sektorit joqeveritar dhe 2 gazetarë)

Qëllimi i trajnimit ishte që pjesëmarrësit të njohohen me termin politikë publike, por edhe të njohohen me procesin e zhvillimit dhe implementimit të strategjive për përfaqësim të së drejtave të bashkësive etnike jo shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Në fillim të trajnimit ligjëruesit duke shfrytëzuar qasje interaktive, prezantuan definicione të ndryshme të termit politikë publike duke i përcaktuar aktorët e politikës publike të cilët mundën të ndikojnë në procesin e krijimit të saj. Në vazhdim të trajnimit u përpunuan konceptet e përfaqësimit publik si edhe qëllimet dhe detyrat e tij. Në pjesën praktike pjesëmarrësit u ndanë në 4 grupe punuese, kurse nga puna në grupe rrodhën temat në vijim të cilat mundën ta pasqyrojnë jetën në bashkësitë e tyre etnike dhe mundën të jenë objekt i përfaqësimit publik: mundësimi i kushteve për implementimin e mësimin në gjuhën boshnjake në f. Ljubin dhe f. Orizare, zvogëlimi i numrit të fëmijëve në rrugë nëpërmjet përfshirjes së tyre në procesin arsimor, sigurimin e lokalitetit në Shkup për ndërtimin e Qendrës për ruajtjen e kulturës së bashkësive etnike jo shumicë dhe rritjen e mundësisë për shkollim të fëmijëve nga familjet e rrezikuara sociale duke u siguruar libra falas. Në vazhdim diskutimet u drejtuan kah publiku qëllimor, përpilimi e kartës së fuqisë, elementet e lotimit dhe formimit të përkrahjes nëpërmjet formimit të rrjeteve dhe koalicioneve. Në fund u prezantua edhe formati i planit për zbatimin e përfaqësimit publik sipas të cilit duhet të caktohet qartë secili aktivitet veçmas për shkak të realizimit më të lehtë të asaj që është planifikuar.

Pjesëmarrësit ishin të përkushtuar në kryerjen e detyrave dhe hapur i shkëmbyen përvojat e tyre të deritanishme gjatë sesioneve të parapara për diskutime.

Trajnimin e realizuan Marija Savovska dhe Lidija Ilijevska nga organizata joqeveritare e grave “Akcija Zdruzhenska”. Mandika Niça dhe Mujo Skenderoviq morën pjesë si trajnues asistent në kuadër të programit Trajnim për Trajnues. Trajnimi, i cili u mbulua nga redaksia vllahe pranë MT-s, e organizoi Fondacioni Institut Shoqëri e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me “Vlera të përbashkëta” nga Shkupi.